



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.151/16 prot.

Datë 08/03/2024

V E N D I M
Nr. 253 / 2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08/03/2024, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 212/2024, datë 22.02.2024 për procedurën e prokurimit “Proçedure e Hapur”, me objekt “Zëvendësim i pjesshëm i tubacionit magjstral Ø 6” nga Qendra nr. 17 Drenove deri në Dekantim Usoje” me Nr. REF-91395-12-18-2023 me fond limit: 204,015,287 (dyqind e katër milion e pesëmbëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 26.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol sh.a.

Autoriteti Kontraktor: Albpetrol sh.a me adresë Selia Rruga Fier – Patos, km 7.

Ankimues: “VIBTIS” SHPK me NIPT L02103503S dhe me adresë Blv. Dëshmorët e Kombit, Twin Tower, Kulla nr.2, kati 8/4.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 22.02.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.212/2024, ku vendosi:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik "VIBTIS" SHPK, për procedurën e prokurimit, "Procedurë e Hapur", me objekt "Zëvendësim i pjesshëm i tubacionit magjistral Ø 6" nga Qendra nr. 17 Drenove deri në Dekantim Usoje" me Nr. REF-91395-12-18-2023 me fond limit: 204,015,287 (dyqind e katër milion e pesëmbëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar në datën 26.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol sh.a.
 2. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "VIBTIS" SHPK për modifikim të dokumenteve të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
 3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në dokumentet e tenderit sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet dhe sqarimet e nevojshme, në sistemin elektronik të prokurimeve.
 4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
 5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues "VIBTIS" SHPK.
 6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 1319 prot., datë 27.02.2024, protokolluar me tonën nr. 151/13 prot., datë 01.03.2024, autoriteti kontraktor, njofton se: "Autoriteti kontraktor, Albpetrol sh.a. pas njohjes me vendimin e KPP Nr. 212/2024 datë 22.02.2024, për procedurën e prokurimit, me objekt "Zëvendësim i pjesshëm i tubacionit magjistral Ø 6" nga Qendra nr. 17 Drenove deri në Dekantim Usoje" me Nr. REF-91395-12-18-2023, ju njofton se ka zbatuar vendimin duke modifikuar dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e Komisionit të Prokurimit Publik në këtë vendim. Për këtë qëllim, autoriteti kontraktor ka hartuar dhe publikuar shtojcën përkatëse në SPE dhe është në pritje të heqjes nga pezullimi për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave të prokurimit (shtojca bashkëlidhur)".

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1 Me shkresën nr. 1319 prot., datë 27.02.2024, protokolluar me tonën nr. 151/13 prot., datë 01.03.2024, autoriteti kontraktor, njofton se: "Autoriteti kontraktor, Albpetrol sh.a. pas njohjes me vendimin e KPP Nr. 212/2024 datë 22.02.2024, për procedurën e prokurimit, me objekt "Zëvendësim i pjesshëm i tubacionit magjistral Ø 6" nga Qendra nr. 17 Drenove deri në Dekantim Usoje" me Nr. REF-91395-12-18-2023, ju njofton se ka zbatuar vendimin duke

modifikuar dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e Komisionit të Prokurimit Publik në këtë vendim. Për këtë qëllim, autoriteti kontraktor ka hartuar dhe publikuar shtojcën përkatëse në SPE dhe është në pritje të heqjes nga pezullimi për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave të prokurimit (shtojca bashkëlidhur)”.

II.2. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, konstatohet, se autoriteti kontraktor ka modifikuar dokumentat e tenderit, nëpërmjet një shtojce për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së mësipërme të prokurimit, dhe e ka publikuar, e cila është në përputhje me vendimin Nr. 212/2024, datë 22.02.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik.

II.3. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor Autoriteti i Albpetrol Sh.A, ka zbatuar vendimin Nr. 212/2024, datë 22.02.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur”, me objekt “Zëvendësim i pjesshëm i tubacionit magjstral Ø 6" nga Qendra nr. 17 Drenove deri në Dekantim Usoje” me Nr. REF-91395-12-18-2023 me fond limit: 204,015,287 (dyqind e katër milion e pesëmbëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 26.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol Sh.A.
 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar

Fioorent Zguro

Anëtar

Kreshnik Ternova

Kryetar

Jonaid Myzyri

